



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:235203

Datë: 11.12.2023

Numri i dokumentit: 05044446

P.nr. 769/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Alan Taraniš, në çështjen penale kundër të pandehurit S.B.nga Peja, i akuzuar për vepër penale “Sulm” nga neni 184 par. 1 të KPRK-së, sipas Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm nën shenjen PP/II Nr. 1835/2021 dt. 19.10.2021, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit fillestar me dt. 15.11.2023, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Sadije Muriqi, të pandehurit S.B., të dëmtuarit Y.B.dhe mbrojtëses së viktimave Arta Muhaxheri Gjevukaj, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 11.12.2023. përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

S.B., me nr. personal, i lindur më në Pejë, me vendbanim në rr..M.M, nr.62, i biri i F dhe nënës Fe gjinisë Q,, ka . fëmijë, ka kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, nr.tel....., i pa dënuar me pare nga gjykata, Shqiptar, shtetas i RKS-se, mbrohet në liri,

ËSHTË FAJTOR

Për shkak së:

Me datën rreth orës 17:00 në Pejë, në rr. “M.M.“, me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër dhe atë të dëmtuarit ,vëllait të tij Y.B. , në atë mënyrë që ditën kritike për shkak të një mosmarrëveshje pronësore në mes tyre, pasi që kthehen nga seanca gjyqësore në shtëpi, aty fillon konflikti verbal ku i pandehuri fillimisht i drejtohet të dëmtuarit me fjalë fyese e pastaj e sulmon fizikisht duke e shtyrë me duar ,

- Me çka ka kryer vepër penale “**Sulmi**” nga neni 184 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata të njëjtin, në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, , 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70 dhe nenit 184 par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 364, 449, 462, të njëjtin e:

G J Y K O N

- I. Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëqinda tetëdhjete ditësh (180), e i cili dënim fare nuk ka për tu ekzekutuar nëse i njëjti brenda periudhës së verifikimit prej një (1) viti, nuk kryen veprë tjetër penale.
- II. Nëse i pandehuri, brenda periudhës së verifikimit të cekur si më lartë, kryen veprë tjetër penale, dënimi i kushtëzuar si në Piken I do të revokohet dhe do të ekzekutohet.
- III. Obligohet i pandehuri që gjykatës ti paguaje shpenzimet e procedurës penale në formën e paushallit gjyqësor në shumën prej njëzete (20) euro, si dhe taksen për kompensimin e viktimave të krimit në shumën prej njëzete (20) euro, në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. I dëmtuari Y.B.nga Peja, rr.M.M.nr.62 ka hequr dore nga kërkesa pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, me dt. 19.10.2021, ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/II Nr. 1835/2021 kundër të akuzuarit S.B.nga Peja, për shkak të dyshimit të bazuar mirë së ka kryer veprën penale “Sulmi” nga neni 184 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata me dt. 15.11.2023 ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale në të cilën kanë qenë prezentë Prokurorja e Shtetit Sadije Muriqi, i dëmtuari Y.B., mbrojtësja e viktimave Arta Muhaxheri Gjevukaj si dhe i pandehuri S.B..

Në seancën e shqyrtimit fillestar, pasi që të pandehurit nga ana e gjykatës i janë komunikuar të drejtat dhe detyrimet e tij ligjore, si dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, dhe pasi që gjykata është bindur së i akuzuari ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale, të pandehurit i është dhënë mundësia që të deklarohet mbi fajësinë, por paraprakisht i janë shpjeguar kushtet, privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ashtu që i njëjti me vullnet të plote ka deklaruar së pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës, pa asnjë ndryshim.

Gjykata ka marrë mendimin e palëve në procedure lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ashtu që prokurori i Shtetit ka deklaruar së pajtohet me pranimin e fajësie nga ana e të pandehurit.

Mbrojtësja e viktimave po ashtu ka deklaruar së pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, si dhe i dëmtuari Y.B.ka deklaruar së pajtohet me pranimin e fajësisë.

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitën ligjore të nenit 242 par. 2 nën par. 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin së gjykata ka gjetur së i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, së një pranim i tillë paraqet shprehje te lirë të vullnetit të të akuzuarit, së pranimi i fajësisë nga ana e tij po ashtu gjen mbështetje edhe në provat materiale siç janë Raporti i policit V.M i dt. 01.07.2021; raporti i policit K.Z. dt.29.06.2021; raporti i policit F.I i dt.29.06.2021procesverbal i marrjes në pyetje të dëmtuarin / dëshmitarin Y.B.i dt. 29.06.2021; procesverbal i marrjes në pyetje të dyshuarin S.B. i dt. 20.02.2021;. Po ashtu, gjykata ka gjetur së aktakuza në fjale nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike, ashtu që konfirmo dispozitës së nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Prokurori i Shtetit lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit i ka propozuar gjykatës që si rrethana lehtësuese të merret pranimi i fajësisë, ndërsa si rrethane renduese të merret fakti se vepra është kryer brenda marrëdhënies familjare.

Mbrojtësja e viktimave lidhur me natyrën e veprës penale ka deklaruar se sa i përket natyrës se veprës penale, kjo vepër ka ndikuar negativisht tek pala e dëmtuar si në aspektin emocional dhe psiko fizik, pas konsultimit paraprak me palën i dëmtuari heq dorë nga kërkesa pasurore juridike.

I dëmtuari ka deklaruar së pajtohet me fjalën e mbrojtëses se viktimave, heq dorë nga kërkesa pasurore juridike.

I pandehuri lidhur me rrethanat lehtësuese i propozoi gjykatës që si rrethane lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë, raportet e qeta me të dëmtuarin.

Prandaj, me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale të “Sulmit” nga neni 184 par. 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprat penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprat e kryera dhe e ka dëshiruar kryerjen e tyre.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Sa i përket vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së ka gjetur se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën e kryer penale, faktin se i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar për vepër penale nga ana e gjykatës, pendimin e tij dhe faktin se me të dëmtuarin është pajtuar dhe i dëmtuari ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike, ndërsa, si rrethana renduese gjykata ka gjetur si rrethane renduese së vepra penale është kryer në kuadër të marrëdhënies familjare, respektivisht i pandehuri dhe i dëmtuari janë vëllezër.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konfirmo nenit 38 të KPRK-së.

Andaj, gjykata të njëjtit i shqiptoi dënimin e kushtëzuar me burgim si në dispozitiv nr. I të këtij aktgjykimi, në kuptim të nenit 46, 47, 48, dhe 49 e lidhur me nenin 184 par. 1 të KPRK-së.

Në kuptim të nenit 50 të KPRK-së, gjykata do të revokojë dënimin e kushtëzuar nëse i pandehuri kryen vepër tjetër brenda periudhës së verifikimit.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2, nënpar.2.1 dhe nën par. 2.6, të KPRK-së, ndërsa konfirmo nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konform nenit 460 të KPRK-së, të dëmtuarin nuk e udhëzoi në kontest juridiko civil, meqenëse i njëjti ka hequr dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
Divizioni Penal
P.nr.769/21, me datë 11.12.2023.

Zyrtari ligjor,

Alan Taraniš

Gjyqtarja e vetme gjykuese,

Ilda Cucović Sahatçiu

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.